



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 11.07.2019, ora 18:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*). Miratimi në parim i projektligjit.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Lindita Nikolla, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Klajdi Qama.

Mungojnë:

Vilma Bello, Enada Kapllani.

Të ftuar:

Besa Shahini - Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Erzen Tola - drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator,

Vasil Tole – përfaqësues i Akademisë së Shkencave.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Në rendin e ditës së sotme kemi seancën dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh.

Nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi të ftuar zonjën Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe zotin Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Zonja Bisej Kapo, këshilltare e ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nuk është e pranishme.

Po, zonja Ministre, mund ta merrni fjalën.

Besa Shahini – Faleminderit!

Besoj se ju e keni të gjithë informacionin për projektligjin, sepse kam përshtypjen se është hera e tretë që mblidhni persona të ndryshëm, që janë të afektuar nga ligji dhe keni bërë gjithë këtë diskutim.

Desha të bëj një, si të thuash, prezantim fillestar të të gjithë historikut se si kemi arritur deri këtu ku jemi. Më pas, jam e hapur edhe për pyetjet tuaja, nëse di t’u përgjigjem.

Në janar të vitit 2018 është themeluar një grup pune, me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por në përbërje plotësisht me anëtarë të Akademisë së Shkencave, në mënyrë që të fillojë një proces reformimi i Akademisë së Shkencave.

Në frymën e të gjithë punës që bëhet për kërkimin shkencor, është arritur në përfundimin që është e rëndësishme të bëhet edhe një reformim i Akademisë së Shkencave.

Dua të nënvizoj që Akademia e Shkencave nuk është institucion varësie i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Mund të vazhdoj?

Fatjona Dhimitri – Po, vazhdoni.

Besa Shahini – Akademia e Shkencave nuk është në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pra nuk e kemi, si të thuash, në detyrat tona konkrete të merremi me rregullimin e punës së Akademisë së Shkencave. Akademia e Shkencave është një institucion, që duhet të funksionojë në mënyrë të pavarur. Prandaj, në përbërjen e grupit të punës kanë qenë vetëm anëtarët e Akademisë së Shkencave. Për të bërë ndërlidhjen me Ministrinë e Arsimit,

anëtar ka qenë edhe një zëvendësministër i asaj kohe, që është marrë me arsimin e lartë, por nuk ka dhënë ndonjë kontribut në ndërtimin e projektligjit, në mënyrën se si ka ardhur deri tek ju.

Ndërkohë, duke i përcjellë të gjitha procedurat, siç përcillen vazhdimisht, Ministria e Arsimit, kur ka pasur draftligjin e parë, e ka çuar te Këshilli i Ministrave për komente dhe për të gjitha vërejtjet e mundshme. Ka pasur vërejtje dhe komente nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe nga Ministria e Drejtësisë për dy çështje kryesore.

Njëra çështje ka të bëjë kryesisht me buxhetin, nëse ky ndryshim ka efekt financiar dhe pse nuk është reflektuar te relacioni dhe projektligji, pra nuk janë definuar mirë nenet.

Çështja e dytë ka të bëjë me teknikën legislative.

Ndërkohë, kanë ardhur edhe komentet e tjera. Besoj se keni pasur edhe dje një diskutim me profesor Fugën. Nuk ka qenë vetëm profesor Fuga, por ka pasur edhe profesorë të tjerë, të cilët kanë pasur komentet e tyre për projektligjin.

Grupi i punës është rimbledhur dhe i ka reflektuar, sipas tyre, në masë të madhe të gjitha komentet që kanë ardhur, si nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës, Ministria e Drejtësisë, ashtu edhe nga persona të tjerë, profesorë, akademikë, që kanë pasur komente për projektligjin.

Në momentin kur projektligji u mor nga një grup deputetësh, si nismë deputetësh, ne ishim në fazën ku, pas një leximi, pamë që nuk ishin reflektuar siç duhet komentet dhe, që të çohesh prapë në Këshillin e Ministrave, do të duhej edhe pak punë në draft. Pra, ishim në këtë pikë të diskutimit me grupin e punës.

Për të thënë të drejtën, na erdhi mirë që u mor si nismë e deputetëve, për shkak se gjithë diskutimi bëhet në komision, aty ku mund të jepen dhe të prezantohen idetë më të mira në projektligj.

Këshilli i Ministrave, në versionin e fundit që ka ardhur si nismë deputetësh, e ka marrë përsëri në shqyrtim dhe ka sjellë disa komente.

Nëse mund t'i përmbledh, komentet janë përsëri të natyrës buxhetore, të teknikës legislative dhe vijnë nga Ministria e Arsimit, për disa mbivendosje që ka ky projektligj me ligjin për arsimin e lartë.

Për sa i përket buxhetit, është i njëjti koment që ka qenë edhe vitin e kaluar, që, nëse projektligji ka efekt financiar përtej asaj që është paraparë për shpenzimet e Akademisë së Shkencave, kjo duhet të reflektohet në relacion.

Gjithashtu, nëse Akademia e Shkencave tani parasheh të ketë të ardhurat e veta, kjo duhet të rregullohet me një nen të veçantë.

Të bëjmë një shpjegim: dallimi mes ligjit të vitit 2004 dhe 2006 është se Akademisë së Shkencave i janë hequr të gjitha institutet kërkimore, pra dhe mundësia për të krijuar fonde vetiake. Me projektligjin që keni përpara, shtohet mundësia për të themeluar institutet që bëjnë tamam kërkim shkencor, të cilat e mundësojnë akademinë të mos jetë vetëm një organizatë honorifike, e cila riprodhon, si të thuash, vetveten, por edhe të kryejë një punë kërkimore. Në këtë rast, duhet të parashihet me një nen të veçantë mënyra se si krijohen këto fonde dhe pastaj edhe shpenzimi i tyre, që të zbërthehen më tutje në rregullore të ndryshme, në statute e të tjerë.

Për sa i përket teknikës ligjore, ka komente, por unë nuk di t'i relatoj, për shkak se nuk jam juriste. Kemi Erzenin këtu dhe ndoshta ai mund të bëjë disa komente.

Për sa i përket mbivendosjes me ligjin e arsimit të lartë, janë disa pika të disa neneve, të cilat i japin më shumë kompetenca Akademisë së Shkencave në institucionet e arsimit të lartë, që besoj se nuk i takojnë.

Në diskutime të ndryshme, propozimi ynë ka qenë që të marrim modelin e Akademisë së Shkencave në Austri të Vjenës, e cila bën dallimin mes kërkimit shkencor universitar dhe jouniversitar dhe i jep akademisë së shkencave të Austrisë mundësinë të jetë autoriteti më i lartë i shkencës, i kërkimit shkencor, i zhvillimit të kërkimit shkencor për kërkimin shkencor jouniversitar. Pra, nëse ne e shtojmë këtë, si të thuash, term në ligj, e bëjmë këtë dallim dhe nuk kemi më mbivendosje me çështjet që prekin ligjin për arsimin e lartë.

Po ju jap një shembull konkret: përgatitja e shkencëtarëve të rinj, pra neni i parë i ligjit për arsimin e lartë, i vitit 2015, parasheh që institucionet e arsimit të lartë t'i përgatitin ata me grada dhe tituj shkencorë, ndërsa ky ligj, që është përpara jush, parasheh që këtë e bën Akademia e Shkencave. Thjesht janë disa rregullime të vogla, të cilat e largojnë këtë konflikt fillestar nga terminologjia.

Risia kryesore e këtij projektligji është se i mundëson Akademisë të mos jetë vetëm një organizatë honorifike, por të kryejë mirëfilli kërkim shkencor, nëse e sheh të nevojshme dhe nëse arrin të ndërtojë kapacitetet e saj. Këtë e bën jo vetëm përmes instituteve, siç ka qenë e paraparë, por edhe përmes komisioneve, që ngrihen për tema të caktuara dhe ato kryejnë një kërkim shkencor, që mund të jetë në funksion të diçkaje, që u nevojitet si institucioneve publike, ashtu edhe institucioneve të tjera.

Ne kemi pasur dy propozime, që mendoj se shkojnë përtej asaj që ka paramenduar grupi i punës. Në përgjithësi, mendoj se janë shumë të vlefshme. Një propozim është që secili institucion i ri, që themelohet apo rirregullohet me ligje të reja, duhet të ketë parasysh barazinë gjinore.

Unë mendoj se Akademia e Shkencave deri tani ka qenë një institucion që ka promovuar kryesisht burrat. Duhet të kemi shumë më shumë gra, të cilat, me kontributin e tyre shkencor, duhet të promovohen. Kjo duhet të shprehet me ligj në mënyrë të qartë, që gratë të mund të promovohen më lehtë.

Propozimi i dytë është një ide e vjetër, por doja të reflektohej disi në projektligj dhe është i mundur të pjesa e parimeve bazë dhe funksioneve kryesore.

Sot në trevat shqiptare kemi shumë akademi shkencash, që pak a shumë bëjnë të njëjtën gjë ose shpeshherë bëjnë të njëjtën gjë në shtete të ndryshme.

Është mirë të fillojmë një proces të federalizimit të këtyre akademive të shkencave dhe të shkojmë drejt krijimit të një akademie shkencash shqiptare. Ky është një propozim yni. Pra, nuk kemi nevojë të shkojmë direkt te shkrirja e akademive të shkencave. Federalizimi do të ishte një gjë e mirë, sepse akademia shqiptare duhet të jetë vetëm një dhe të gjithë akademikët, profesorët dhe personat që japin kontribut shkencor, të mund të punojnë bashkë dhe të mos kemi 3 monografi, 3 fjalorë, 3 dokumente për të njëjtat tema, por të kemi një, ku të marrim mendjet më të ndritura të të gjitha trevave shqiptare dhe t'i bashkojmë. Por kjo, natyrisht, nuk rregullohet me ligj. Ne reflektojmë dëshirën për ta çuar drejt një federalizimi të gjithë këtë bashkësi të akademive të shkencave, por duke u nisur nga Akademia kryesore e Shkencave me bazë në Tiranë.

Do ta ndërpres këtu hyrjen fillestare. Nëse keni pyetje konkrete, me shumë dëshirë do t'u përgjigjem.

Fatjona Dhimitri – Para se të filloj me pyetjet, po jua lë radhën juve. A dëshiron dikush nga ju t'i bëjë pyetje ministres?

Po, urdhëroni!

Milva Ekonomi – Zonja Ministre, faleminderit shumë për shpjegimin!

Doja të dija mendimin tuaj për vendimin e Këshillit të Ministrave për rishikimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave”. Janë dy nene aty, që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor, ku ka një mbivendosje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

Ju gjykoni që ne duhet ta reflektojmë këtë gjë te projektligji që kemi në duar?

Besa Shahini - Faleminderit për pyetjen!

Gjithsesi, unë mendoj se duhet të reflektohen. Besoj se kjo është e lehtë, sepse kaluam pak kohë edhe sot për ta riparë edhe një herë këtë.

Hiqen disa pika të dy neneve. Unë mendoj se mund ta bëjmë edhe më të qartë dallimin mes kërkimit shkencor universitar dhe jouniversitar, nëse thjesht në projektligjin “Për Akademinë e Shkencave” vendosim edhe termin “jouniversitar”. Pra, në fillim, kur të flasim

për rolin dhe funksionin, të themi që ky institucion është më i larti përfaqësues për kërkimin shkencor jouniversitar. Pastaj bëhet dallimi i qartë dhe nuk kemi më mbivendosje mes ligjit ekzistues për arsimin e lartë dhe ligjit të ri, që po reformon Akademinë e Shkencave.

Fatjona Dhimitri – A dëshiron dikush tjetër nga komisioni të bëjë pyetje?

Urdhëroni, zoti Nasufi!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja Ministre!

Ka një draft të plotë të paketës ligjore për të gjitha këto institucione, që, përveç Akademisë, të jetë edhe ligji për kërkimin shkencor, ligji për shkencën, që të mbyllet mirë dhe t'i paraprihet nismës ligjore për këto fusha?

Marr shkas edhe nga fakti që, nga dëgjesat që kemi bërë këtu, aludohet edhe për mbivendosje ose moskoherencë të ligjit për arsimin e lartë me ligjin për Akademinë e Shkencave, ose për institucionet paralele të kërkimit shkencor që kanë universitetet, me ato që presupozohet të jenë edhe në tagrin e Akademisë së Shkencave.

Së dyti, dëgjesat ose iniciativat personale, që ne kemi mirësinë t'i dëgjojmë, duhet të jenë në akord me nismën ligjore, me të drejtën kushtetuese, që nismat ligjore i merr Këshilli i Ministrave, ministria, një grup deputetësh ose 17 mijë firma, se neve na vijnë këtu platforma paralele.

Do ta marrim edhe mendimin ndryshe, ama, do të respektojmë ligjin dhe Kushtetutën për këto pika.

Së treti, ju folët për një mundësi federalizimi të akademive të shkencave. Për mua, kjo krijon një lloj pështjellimi në kohën kur po diskutojmë ligjin. Ne duhet të diskutojmë këtu ligjin e Akademisë së Shkencave, pastaj iniciativat e institucioneve akademike mbarëshqiptare mund të jenë një fazë tjetër bashkëpunimi, kooperimi, programi e me radhë.

Unë them të fokusohemi te problemi i një ligji, sepse këtu bën më shumë jehonë lajmi sesa përmbajtja e ligjit që kemi në diskutim. Këtë e kisha më shumë si vërejtje.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Urdhëroni!

Besa Shahini – Faleminderit!

Projektligji “Për kërkimin shkencor” është një draft i përfunduar dhe është në konsultim me institucionet e arsimit të lartë. Duhet të rishikohet, para se të shkojë te Këshilli i Ministrave dhe është pjesë e strategjisë së përgjithshme për shkencën dhe inovacionin. Ajo do të vijë më vonë, pra është në sesionin e vjeshtës. Unë besoj se do të vijë në komision, që ju të kaloni nëpër të.

Mbivendosja, që është identifikuar nga Këshilli i Ministrave, mes projektligjit që keni përpara dhe ligjit për arsimin e lartë, siç u shpreha, mund të rregullohet me heqjen e disa pikave të dy neneve dhe me vendosjen e definimit të kërimit shkencor jouniversitar, ndaras nga kërkiti shkencor universitar.

Këto janë identifikuar edhe nga persona juristë në Këshillin e Ministrave apo të ministrive të ndryshme, që e kanë bërë gati dokumentin, të cilin e keni parë edhe ju. Kështu që besoj se me një intervenim të shpejtë mund të bëhet ky rregullim, që të mos ketë më konflikt dhe mbivendosje.

Platformat paralele ju mund t'i shihni si të doni. Unë i kam parë si mendime të personave të tjerë, që kanë qenë të angazhuar për të zhvilluar shkencën, kërkitimin shkencor dhe Akademinë në Shqipëri, dhe janë gjithmonë të vlefshme si mendime, por projektligji është vetëm një, pra ekziston vetëm një dokument zyrtar, që është projektligji që keni sjellë ju, si nismë deputetësh.

Jeni absolutisht në të drejtën tuaj të kërkonit të mos e diskutojmë tani federalizimin. Kjo është plotësisht e drejtë. Ky ishte vetëm një mendim që kishim ne, si ministri, pasi e kishim diskutuar edhe me kolegët tanë. Ngaqë vij nga Kosova dhe ata e morën vesh që po diskutohej projektligji “Për Akademinë e Shkencave”, u bë një diskutim me kolegët tanë në Prishtinë. Gjithsesi, kjo mund të jetë një nismë që vjen pas miratimit të projektligjit, një nismë që e merr vetë Akademia e Shkencave. Pra, është plotësisht në të drejtën tuaj të kërkonit të mos vijojmë ta diskutojmë këtë pikë më tutje.

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera?

Bujar Çela – Zonja Ministre, faleminderit për shpjegimin!

Kemi dëgjuar një seri pedagogësh, akademikësh, kemi dëgjuar edhe mendime ndryshe. Krahas kësaj që thatë, ne, si komision, kemi qenë në një takim me Akademinë e Shkencave në Kosovë. Kemi mbetur të kënaqur. Ndoshta pamë edhe që ishim pak mbrapa tyre nga historiku, por edhe nga investimet e bëra për Akademinë e Shkencave në Kosovë.

Këtë që prononcuat ju në këtë komision, është hera e parë që e dëgjoj, por nuk ka rëndësi kjo.

Pyetja ime është shumë e thjeshtë: në rolin e ministres, se keni njohje edhe pak më të gjerë me Akademinë e Shkencave dhe ato mbarëkombëtare në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, pa dashur që kjo të dalë jashtë kësaj dere, si janë ligjet e tyre? Ligji ynë, projektligji që ne kemi bërë, si grup deputetësh a qeveri, a ka ngjashmëri me to? A po e afrojmë ne ligjin drejt perspektives, që unë mendoj se nuk do të lindë prej nesh, por prej akademive, në rast se ata e shohin si një zgjidhje ose si një perspektivë të shkencës shqiptare?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Ju, Bujar, po na flisni për shkrirje të akademive? Se shpesh zonja ministre në deklaratat e saj, citon shkrirjen e akademisë shqiptare sipas modeleve të Kosovës e të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht, pra!

Po, zonja ministre mund të përgjigjet.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besa Shahini – Pyetja ishte shumë e qartë. Unë nuk kam bërë krahasim të tri ligjeve. Kështu që nuk mund të përgjigjem sot. Kjo është një gjë që mund ta marrim përsipër ta bëjmë.

Çështja e federalizimit të akademive dhe shkuarja drejt një akademie shqiptare, mendoj se është në frymën e të gjitha politikave që kemi si komb, ku për herë të parë kemi mundësinë të flasim lirshëm për bashkëpunime në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe Akademinë e Shkencave. Ky është një moment, ku pasi po diskutohet projektligji, pse të mos diskutohen të gjitha çështjet që janë në tavolinë për këtë temë?

Me Ministrinë e Arsimit në Kosovë ne kemi një bashkëpunim në ndërtimin e kurrikulave të arsimit parauniversitar, për abetaren e përbashkët dhe po mundohemi të bëjmë edhe harmonizimin e librave të tjerë. Në këtë frymë, ideja është të shohim se cilat janë të gjitha mundësitë ku dy shtetet mund të funksionojnë si një, përkundër faktit që janë dy shtete të ndara me kufij.

Kjo është e gjitha.

Fatjona Dhimitri - Zonja Ministre, kam edhe unë disa pyetje për ju.

Do të ta jap fjalën pak më vonë, Ismet.

Sikundër jemi në dijeni nga media apo vetë të ftuarit, që kemi pasur gjatë këtyre ditëve për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave”, zonja Ministre, përse lejuat ju që këtë tekst projektligji t’jua merrnin deputetët, kur puna po mbaronte? Pra, sikundër e dimë edhe vetë historikun apo procedurën e draftimit të këtij projektligji, ka pasur një grup reformator për ndërtimin e këtij projektligji, kur në komisionin tonë na u soll si një draft i sjellë nga një grup iniciatorësh, nga një grup deputetësh. Si mendoni ju?

Në vërejtjet apo në kthimin e përgjigjes nga Këshilli i Ministrave, ky tekst duket se është në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë. Si mendoni ju?

Cilat janë ndryshimet që sjell ky projektligj në raport me atë ekzistues, në qoftë se ne heqim shkeljet, sipas vërejtjeve të shkresës së sjellë nga Këshilli i Ministrave?

Zonja Ministre, përse ju nuk i dhatë edhe zonjës Gjermani apo grupit të iniciatorëve, që na sollën këtu këtë lloj platforme, edhe platformën “Fuga”, pasi ashtu sikundër është provuar në medie, ekziston një platformë e tillë? Përse nuk ia dhatë krahas kësaj platforme edhe platformën “Fuga”?

Përse ju nuk keni pranuar ta takoni zotin Fuga, kur ai ka kërkuar një takim me ju dhe ka plotësuar formularin njëlloj si të gjithë qytetarët e tjerë, që kërkojnë takim me ju?

Zonja Ministre, përse ju, zakonisht, siç ju kemi dëgjuar edhe në medie, bëni deklaratatë tilla të shkrirjes së akademive, të akademisë shqiptare me akademitë e rajonit...?

Po, i kemi dëgjuar.

Pyetjet po i drejtoj unë, zonja Kumbaro. Ju vijoni me pyetjet tuaja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, ne do të bëjmë një projektligj në të mirë të akademisë shqiptare apo projektligji ynë do të ketë një raport varësie me ligjet e tjera të Kosovës apo të rajonit?

Urdhëroni!

Milva Ekonomi – Kam diçka për procedurë. Zonja kryetare, ju keni të drejtë të bëni çdo pyetje që doni, por që ju të bëheni avokate e zërit të zotit Fuga në komision, kjo është një gjë që na turpëron të gjithëve ne, si komision! Ju nuk mund të...

Fatjona Dhimitri – Milva...

Milva Ekonomi – Më fal, ta mbaroj dyminutëshin tim dhe pastaj vazhdoni ju!

Ju nuk mund të merrni zërin e zotit Fuga dhe ta vini në emër të komisionit. Ju thoni: “Unë, si kryetare, po bëj disa pyetje”. Jo, nuk mund të jetë kështu, se ju, si kryetare, nuk mund t’i bëni këto lloj pyetje!

Nuk mund t’i thoni ju ministres: “Pse nuk na ke sjellë platformën e Fugës?”.

Fatjona Dhimitri – Tani i bie që ju po bëheni avokate e zonjës ministre këtu. Në fakt, i pranishëm duhet të ishte edhe zoti Shtino këtu, sepse ka qenë zëvendësministri përgjegjës teknik për reformën...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A do të më lësh ta mbaroj?

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të ishte edhe zoti Shtino. I kam kërkuar të vijë, por nuk e di pse nuk ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të vinte edhe sot dhe të jepte përgjigjet respektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Zonja Kryetare, unë ju bëj një ftesë me shumë zemër: ju lutem, lexojeni Rregulloren se si funksionon Kuvendi! Ju lutem, lexojini detyrat hierarkike që kanë institucionet në Republikën e Shqipërisë, se çfarë detyre ka Kuvendi dhe çfarë detyrash kanë ministrat dhe mos bëni të tilla pyetje, sepse është turp për të gjithë anëtarët e komisionit, majtas apo djathtas, që ju t’u drejtoni këto pyetje të ftuarve!

Do t’ju lutesha shumë që këto gjëra të shihen me kujdes! Në qoftë se zoti Fuga ka dashur t’ju japë pyetje dhe t’i vërë ato në gojën tuaj për t’ia thënë ministres, sepse nuk i bëri vetë, ju nuk duhet ta kishit pranuar këtë, sepse zoti Fuga, si kurrë ndonjëherë, me shumicën tonë të votave, u pranua të vinte si platformist dhe nuk erdhi me asamblenë e akademikëve, se nuk pranoi. Kështu që...

Fatjona Dhimitri – Këto nuk janë pyetjet e zotit Fuga, por janë pyetje që kanë lindur nga mbledhja e të gjitha diskutimeve me të gjithë të ftuarit tanë.

Milva Ekonomi – Ku i mblodhe të gjitha diskutimet, kur zoti Ismet dje...?!

Fatjona Dhimitri – Milva, nuk po bëj avokatin e askujt këtu! As ju mos bëni avokaten e ministres. Ministria ka ardhur në seancë dëgjimore. Le ta dëgjojmë! Ju dëgjova kur bëtë pyetjet tuaja dhe zonja u përgjigj. Tani, unë kam pyetjet e mia dhe le të përgjigjet ministria!

Milva Ekonomi – Dakord, por duhet të mësoni një gjë: fjala nuk i pritët në mes atij që flet. Më lër ta mbaroj mendimin tim, pastaj më ndërhy!

Gjëja tjetër që dua të them është që nga dje kemi edhe një koment shtesë për gjërat që thatë ju. Platforma e zotit Fuga ka qenë në *site*-n e parlamentit. Të gjithë ne, anëtarët e komisionit, e kemi marrë nga *web*-i i parlamentit. Këtë gjë vendoseni te shënimet tuaja dhe mos e thoni me zë në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ç’është kjo?!

Fatjona Dhimitri – Zonja Ministre, dëshironi t’u përgjigjeni pyetjeve?

Urdhëroni!

Besa Shahini – Shumë faleminderit për pyetjet!

Kërkuat të ishte prezent edhe zoti Shtino, zëvendësministri që mbulon arsimin e lartë. Ai, në fakt, ka qenë prezent në të gjitha seancat e tjera dëgjimore. Specifikisht, është kërkuar të vij unë, edhe pse e kemi shpjeguar që Akademia e Shkencave nuk është një institucion varësie dhe nuk ka nevojë të vijë ministri, sepse kjo është një nismë deputetësh për të ndryshuar projektligjin, por ju të gjithë insistuat të jetë ministri. Dhe unë, me respektin që kam, veçanërisht për këtë komision, por në përgjithësi për parlamentin shqiptar, erdha sot për të bërë

këtë bashkëbisedim me ju, me të gjithë informacionin që kam, jam e hapur t'ua përgjigjem të gjitha pyetjeve që keni.

Ne nuk penguan një grup deputetësh ta merrte projektligjin dhe ta sillte këtu. Kjo është e drejtë e deputetëve, që, me një grup, me një numër të caktuar deputetësh, të sjellin...

Milva Ekonomi – Qoftë edhe një.

Besa Shahini - ... një projektligj për diskutim.

Siç e shpjegova, ne kemi qenë në një proces, ku grupi i punës ka qenë i përbërë totalisht nga anëtarët e Akademisë së Shkencave, por, natyrisht, i themeluar nga Ministria e Arsimit, sepse duhej të atashohej diku. Ministria e Arsimit ka shërbyer vetëm si medium i diskutimeve për reformimin e Akademisë së Shkencave, por ngaqë nuk e ka në varësi, nuk ka pasur ndonjë rol tjetër përtej kësaj. Projektligji i hartuar ka qenë në konsultime me ministritë e tjera.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka pasur komente, edhe Ministria e Drejtësisë ka pasur komente, të cilat nuk janë reflektuar tamam në projektligj dhe ka qenë procesi i reflektimit të atyre komenteve në dokument.

Në të njëjtën kohë që ndodhte kjo, sepse ky është një proces që merr kohën e vet, si të gjitha projektligjet e tjera, një grup deputetësh vendosën ta sjellin për diskutim këtu, që të bëhej një diskutim i hapur për projektligjin për Akademinë e Shkencave.

Gjithsesi, ne kemi qenë të lumtur për këtë, sepse unë mendoj se çfarëdo diskutimi i hapur, rreth çfarëdo teme, është i mirëseardhur. Kështu që thjesht jemi bërë pjesë e nismës suaj me një punë që është bërë nga grupi i punës, i përbërë nga Akademia e Shkencave.

Kundërshtimet me ligjin për arsimin e lartë, që i ka sjellë Këshilli i Ministrave si komente, kur është dërguar projektligji “Për Akademinë e Shkencave”, janë mbivendosje të disa kompetencave në disa nene dhe pika specifike. Kjo mund të rregullohet me heqjen e disa pikave dhe me një definim më të mirë të kërkimit shkencor, që e rregullon ky projektligj. Pra, nëse ligji për arsimin e lartë e prek kërkimin shkencor, që ndodh brenda universitetit, ne mund të marrim modelin e Austrisë këtu dhe të themi që Akademia e Shkencave merret me kërkimin shkencor apo është përfaqësimi më i lartë i kërkimit shkencor jouniversitar.

Edhe një herë, ky është vetëm një propozim yni, nga leximet tona, dhe nuk është një gjë që duhet të merret patjetër parasysh. Ky është një propozim, që mund ta zgjidhte këtë mbivendosje të kompetencave apo të heqim nga projektligji disa nga pikat specifike, nga disa nene që janë të listuara në komentet që i keni marrë nga Këshilli i Ministrave.

Për pyetjen se pse nuk i kemi dhënë apo i kemi dhënë platformën, komentet ose jokomentet grupit të deputetëve, që kanë qenë nismëtarë të projektligjit, e morët përgjigjen nga

zonja Ekonomi. Ne nuk kemi dhënë apo mbajtur asnjë gjë. Projektligji ka ardhur si nismë e deputetëve, ashtu siç ju është dhënë nga grupi i punës, i cili ka punuar në projektligj.

Më pyetët se pse nuk jam takuar me zotin Fuga. Unë, absolutisht, jam takuar me zotin Fuga. Ne e kemi bërë diskutimin në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ndoshta nuk jam takuar herën e dytë, kur ai ka takuar takim, për shkak se nuk kam qenë aty fizikisht, por unë takoj, absolutisht, secilin person, qytetar, pedagog, profesor, mësues, drejtor shkollash që kërkon takim dhe ne mundohemi t'i zgjidhim të gjitha çështjet që ata i sjellin për diskutim.

Pyetja e fundit ishte se përse bëhej deklarata për federalizimin e akademive të shkencave shqiptare, domethënë pse e artikuloj synimin që duhet ta kenë akademitë e shkencave për themelimin e një akademie shqiptare të shkencave.

Kjo ndodh për shkak se unë besoj thellësisht që ne, si komb, ngaqë jemi komb i vogël në krahasim me kombet e tjera, mund të zhvillohemi dhe të ecim para vetëm nëse i bëjmë bashkë të gjitha forcat tona. Pra, mendjet tona më të ndritura, idetë tona më të mira, duhet të bëhen bashkë, në mënyrë që të ecim para.

Unë ndihem shumë fatlume që jetoj në një kohë kur ne mund ta bëjmë haptazi këtë diskutim, pa u strukur. Unë vij nga Kosova dhe në vitin '90 nuk kemi guxuar as ta përmendim këtë gjë. Sot jam shumë e lumtur që jetoj në një kohë kur këto ide mund të rrihen dhe mund të shtyhen para dhe ne bashkërisht mund ta çojmë Kosovën, Shqipërinë dhe të gjithë viset ku jetojnë shqiptarët, para në mënyrën më të mirë të mundshme.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Urdhëro, Ismet!

Ismet Beqiraj – Kur është prezantuar në këtë komision, një nga risitë që ka sjellë projektligji është hapja drejt komuniteteve shkencore, si instituteve, institucioneve të arsimit të lartë dhe, duke parë edhe mendimin që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave, por edhe disa mendime...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...që dhanë përfaqësuesit ose rektorët e universiteteve dje për frikën e mbivendosjes...

Fatjona Dhimitri – Milva, ju thoni versionin që ju intereson juve.

Milva Ekonomi – Cilin version?

Fatjona Dhimitri – Versionin që i intereson ministres.

Urdhëroni, Ismet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryetare, pse sa herë flas unë, ju ndërhyjnë?!

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Ismet Beqiraj - E thashë edhe njëherë, një nga risitë e këtij projektligji, kur është prezantuar, është hapja ndaj institucioneve të komunitetit shkencor, qoftë të instituteve, qoftë të universiteteve ose institucioneve të arsimit të lartë, publikë dhe jopublikë, se nuk mund t'i parcelojmë. Akademia e Shkencave është një dhe i përfaqëson të gjitha këto institucione.

Me të drejtë, janë edhe mendimet që vijnë nga Këshilli i Ministrave, për mbivendosje të ligjshmërisë me ligjin e institucioneve të arsimit të lartë, që ka të bëjë me pikën 8 të nenit 9, për pjesëmarrjen në senate. Për ta shmangur këtë mbivendosje ligjore, të krijojmë mundësi hapjeje dhe bashkëpunimi, sepse pjesëmarrja reciproke, qoftë e organeve drejtuese të Akademisë së Shkencave, qoftë edhe e institucioneve të arsimit të lartë, është një gjë e domosdoshme, edhe në kuadër të hapjes. Si mendoni?

Ju thatë se kemi mbivendosje dhe mund ta heqim këtë pikë, ndërsa unë kam një qasje tjetër, ku të vendosen në një balancë reciproke të dyja institucionet për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

Çfarë mendimi keni ju?

Besa Shahini – Faleminderit për pyetjen!

Edhe njëherë, dua të nënvizoj që këto që po themi janë vetëm propozime tona, që ju të mund t'i reflektoni, nëse i shihni si të drejta, në projektligjin që ka ardhur si nismë e deputetëve dhe po diskutohet në komision. Kështu që një riformulim i pikës së caktuar, nenit të caktuar, që vjen sot në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë, gjithashtu, do të ishte një zgjidhje e mirë e këtij konflikti, në mënyrë që të mos e kemi, sepse ligji i arsimit të lartë, i vitit 2015, është në fuqi dhe nuk do të duhej të kishim një bazë tjetër ligjore, që po ndërtohet tani, e cila bie ndesh me të. Kështu që, çfarëdo zgjidhje që ju mendoni se është e drejtë dhe e mirë në këtë rast, jeni të lirë ta propozoni, ta përfshini te projektligji dhe ta çoni para.

Fidel Ylli – A mundem?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Fidel Ylli – Dua që shkurtimisht të bëj dy pyetje.

Pyetja e parë është për ju, zonja Ministre. Pyetja e dytë është përsëri për ju, por më tepër është një pyetje retorike.

Së pari, ne këtu në komision e kemi marrë me shumë seriozitet, si të gjitha projektligjet, por veçanërisht kemi qenë shumë të kujdesshëm për sa i përket projektligjit “Për Akademinë e Shkencës” dhe në seanca të gjata kemi dëgjuar me shumë vëmendje gjithë akademikët që kanë

ardhur. Përsëri morëm një vendim, si komision, që do të dëgjonim edhe të gjithë rektorët, pra grupet e interesit, që të bëhet një ligj sa më pak i kontestuar dhe sa më i mirë për vendin tonë.

Në të gjitha dëgjesat që bëmë, kishte nja dy vërejtje, që i theksuat edhe ju, për sa i përket kërkimit shkencor. Rektorët kishin edhe një problem për anëtarësimin në senate, që bie ndesh me ligji e arsimit të lartë. Megjithatë, këto janë gjëra që besoj se bashkërisht, edhe me komisionin, do t'i marrim në konsideratë për t'i rregulluar.

Pyetja ime është për sa i përket platformës "Fuga". Unë e vlerësoj zotin Fuga për iniciativën që ka ndërmarrë për të bërë një gjë ndryshe, sepse ka nevojë edhe për zëra ndryshe.

Më intereson mendimi juaj, si ministri, për këtë platformë, që duhet parë në thelb të saj dhe në nene të veçanta, sepse gati të gjithë akademikët, 99% e asamblesë së Akademisë së Shkencave, kanë qenë kundër kësaj platforme dhe të gjithë rektorët që erdhën në komision bënë vetëm këto dy vërejtje.

Cili është mendimi juaj për këtë platformë? Se ka shumë rëndësi t'i marrim në konsideratë zërat ndryshe, por kjo të mos jetë çështje numrash. 99% e rrëzon, por qoftë edhe ky 1%, në një moment, nëse do të arrijë të na bindë të gjithëve, edhe mund ta përmbysë platformën. Prandaj më intereson ky mendim.

Për pyetjen e dytë, për debatin që ju bëtë me kryetaren e komisionit për bashkimin e Akademisë së Shkencave me akademitë e shkencave të kombit tonë, unë dua t'ju jap një shembull.

Në vitin 2013 unë kam qenë në një grup punë për reformën në sport. Fushatën e parë e kam bërë në Kosovë, jo për ta shpalosur këtë platformë dhe për të marrë vota në Kosovë, se nuk kishte lidhje, sepse Kosova është shtet më vete, por me idenë që ne, si komb, vlerat tona duhet t'i bashkojmë në një kampionat të vetëm. Pra, aty ku ne kemi sporte shumë herë më të zhvilluara se Kosova, të kemi një kampionat të përbashkët dhe, aty ku Kosova ka sporte me kampionë më të mëdhenj se ne, deri te kampionët olimpike, si Kelmendi e të tjerë, të kemi mundësi për një aktivitet të përbashkët dhe të jemi të kujdesshëm në aktivitetet ku nuk na lejon FIFA dhe UEFA, siç janë kampionatet e futbollit. Ky ishte qëllimi, për të shprehur në Kosovë që ne jemi një komb dhe kemi të njëjtat tradita, të njëjtat zakone dhe duhet që bashkimin e madh, që e kemi të gjithë dëshirë, ta fillojmë nëpërmjet sportit, artit, kulturës, shkencës, që është një gjë shumë e rëndësishme.

Këtë model unë e kam parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kampionati i hokeyit është i përbashkët me Kanadanë dhe kampionati i basketbollit, NBA-ja, një nga më famozët në botë, është i përbashkët me Kanadanë. Ekipi kampion i NBA-së këtë vit që shkoi ishte ai i Torontos dhe doli për të gjithë Amerikën e Veriut.

Arseja tjetër ka të bëjë me anën ekonomike. Duke rritur më shumë popullsinë, duke rritur më shumë tregun, ne kemi më shumë sponsor, kemi më shumë të ardhura, më shumë shikues në të gjitha aktivitetet tona të sportit. Prandaj, unë i bashkohem nismës që ju thatë. Ajo është një nismë e mirë dhe shumë mendje janë më mirë se pak mendje.

Edhe një herë, faleminderit!

Besa Shahini – Faleminderit për pyetjen!

Edhe një herë, shkurtimisht: mënyra se si ka funksionuar grupi i punës, i cili është themeluar me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por në përbërje vetëm me anëtarë të Akademisë së Shkencave, ka qenë hartimi i projektligjit në mënyrë zyrtare, siç bëhet secila nismë tjetër ligjore. Kur ka shkuar për komente në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Drejtësisë, është kërkuar të përfshihen dhe të reflektohen, si në projektligj, ashtu edhe në relacion, si dhe në çfarëdo platforme, ideje, koncepti tjetër, që do ta përmirësonte projektligjin. Kjo është praktika që ndiqet zakonisht.

Këtu përfshihet edhe platforma e zotit Fuga, e cila fillimisht ka ardhur si një koncept dhe, më pas, si një koncept pak më i zgjeruar, që ai e quan platformë. Sipas grupit të punës, idetë kryesore janë reflektuar në projektligj dhe një pjesë tjetër e ideve ka mbetur për t'u reflektuar në statut.

Unë nuk mund të vlerësoj, as njërën anë, as anën tjetër, pra nuk mund të vlerësoj nëse janë reflektuar siç duhet apo nëse janë marrë idetë më të mira apo jo. Kjo ka mbetur të shkojë prapë në Këshillin e Ministrave dhe në atë pikë ka ardhur këtu për diskutim si nismë e një grupi deputetësh. Gëzohem që është këtu, për shkak se me të vërtetë do të bëhet një diskutim i hapur, i mirëfilltë dhe idetë më të mira jam e bindur që do të reflektohen në këtë projektligj kaq të rëndësishëm, që ju e keni marrë me shumë seriozitet dhe po e çoni para me kaq shumë energji.

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera apo diskutime?

Zonja Ministre, si mendoni ju, projektligji i ri a e ndryshon ndopak gjendjen aktuale të Akademisë?

Besa Shahini – Faleminderit për pyetjen!

Me sa kemi parë me leximin tonë të parë, nga krahasimi mes ligjit të vitit 2004, 2006 dhe projektligjit të sotëm, bëhet një ndryshim substancial nga ajo që ka pasur në përbërje ligji i vitit 2006. Duhet ta kemi parasysh edhe momentin kur është bërë ndryshimi i vitit 2006. Ideja ka qenë për t'u shpërndarë institutet kërkimore nga akademia, për t'u lënë si një organizatë honorifike, vetëm, dhe për të krijuar akademi të tjera, që të ketë më shumë persona që të mund të punojnë bashkërisht në fusha të caktuara dhe jo në grup më të madh, që ta çojnë më para shkencën. Ky problem i shkaktuar nga ligji i vitit 2006 përmirësohet me projektligjin që keni

përpara jush. Kjo është risia kryesore, që jep mundësinë e themelimit të grupeve të ndryshme kërkimore, të instituteve kërkimore ose komisioneve të vogla, të cilat mbledhen *ad hoc* për të bërë kërkim shkencor për një temë të caktuar.

Fatjona Dhimitri – Të gjitha relacionet tuaja, mendimet tuaja, mund...

Dëshironi të thoni diçka?

Po, urdhëroni! Edhe pse ju, zoti Tole, nuk ishit parashikuar sot tek të ftuarit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, por Akademia nuk ju ka vetëm ju përfaqësues, por ka disa. Gjithsesi, mund ta merrni fjalën, meqenëse jeni sot këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ia dhashë fjalën zotit Tole. Më pas juve.

Vasil Tole – Përsëritje! Kam dy fjalë për të thënë, shkurtimisht.

Së pari, dëshiroj të falënderoj zonjën ministre për gjuhën, do ta quaja, paqtuese dhe zhvilluese për projektligjin! I çmoj me shumë vend dhe si korrekte të gjitha ato që tha, për procedurën e hartimit të këtij projektligji dhe, në mënyrë të veçantë, për përgjigjet korrekte që dha për të rehat që sjell projektligji për Akademinë e Shkencave.

Shkurtimisht, dëshiroj t'ju them dy gjëra.

I mbështesim të dyja propozimet që ka bërë ministria për barazinë gjinore, të cilën jemi kujdesur ta pasqyrojmë edhe në këtë projektligj, pra për një përfaqësim më dinjitoz, pavarësisht se nuk mund të ketë një barazi absolute, por proporcionale, le të themi.

Së dyti, më lejoni t'ju them diçka për atë që ministrja e artikulon si akademi mbarëkombëtare. Ne biem plotësisht dakord me këtë, në sensin që, jo se do të bëhet një ndryshim i dhunshëm, por në kuadrin e hapjes së Akademisë, në rast se i referoheni nenit 6, asambleja, pika 3, kemi parashikuar që asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të zgjerojë numrin e anëtarëve të saj përmes kategorisë që quhen anëtarë të jashtëm të Akademisë. Shikojeni formulimin që kemi bërë, duke pasur parasysh, në radhë të parë, bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave dhe Arteve në Kosovë. Kemi thënë: “Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të ALLEA-s, ku Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës është anëtare, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e asamblesë dhe këta të fundit nuk llogariten në numrin e anëtarëve.”

Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që pa bërë, duke iu referuar një standardi evropian, ku një anëtar akademie ka bërë procedurën e vet të anëtarësimit, në këtë rast në Kosovë, nuk kalon më ashtu siç bëhet tani me nominime kokë më kokë. Pra, do të shkosh të

bëhesh anëtar i jashtëm i Akademisë së Kosovës, bën aplikim, shqyrtohet nga komisionet e të tjerë... Ne e quajmë të mirëqenë anëtarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, pra si anëtar të ALLEA-s dhe bëhet automatikisht, në rast se dëshiron, anëtar i Akademisë sonë të Shkencave. Në këtë mënyrë, ne sigurojmë menjëherë, përmes kësaj dispozite ligjore, një asamble mbarëkombëtare. Pastaj aty, zonja Ministre dhe të nderuar deputetë, ne mund të diskutojmë të gjitha çështjet që lidhen me gjëra të përbashkëta, siç i përmendi dhe deputeti Ylli, apo për aktivitete, botime e gjithçka tjetër.

E fundit, për sa u përket atyre që quhen përplasje me ligjin e arsimit të lartë, më besoni, nuk ka asnjë përplasje, ashtu siç konceptohet me ligjin e arsimit të lartë. Ka gjëra që, siç e tha edhe zonja ministre, duhen rregulluar.

Më lejoni t'ju them 2-3 gjëra. Ne nuk marrim përsipër, le të themi, edukimin e shkencëtarëve të rinj, por promovimin e tyre. Ky është një detyrim që lind pas gradës së tretë, pra pas gradës së doktorit të shkencave. Kur kërkojmë përfaqësimin *ex officio*, e kemi thënë, jemi të ndërgjegjshëm që është një çështje debati. Kjo do një lloj mirëkuptimi të përbashkët. Edhe këtë e diskutojmë, gjithmonë në kuadër të hapjes.

Më lejoni t'ju them se ne kemi lënë nga pavarësia jonë, sepse me rregullat e pranimit të anëtarëve të Akademisë së Shkencave sot në asamble, siç ka qenë deri dje të paktën, universitetet, fakultetet dhe departamentet, nuk kishin punë fare. Vinin kandidatët individualisht, aplikonin dhe asambleja votonte. Tani ne e kemi ndryshuar mendimin, sepse e kuptuam që ky është një nga momentet e reformës.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, kemi futur në lojë universitetet, senatet dhe fakultetet, që propozimi i kandidaturave të bëhet në bashkëpunim me këto organizma universitarë.

Për këtë arsye, ne kërkojmë që, duke lënë diçka, të përfitojmë diçka, por jo në sensin personal, si një përfitim material, por si një ndërtim urash bashkëpunimi mes institucioneve tona.

E fundit, zonja Ministre, për sa i përket sugjerimit tuaj për të bërë një korrigjim brenda kërkimit shkencor në universitete dhe jashtë tij, mendoj që Akademia është për kërkimin shkencor në përgjithësi. Sinqerisht, do të kërkoja ta shikonit këtë gjë, sepse një korrigjim i tillë do ta dëmtonte frymën e projektligjit.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Fidel Ylli – Zoti Tole, në seancën dëgjimore që kishim dje, në orën 12:00, me akademikun Fuga, pavarësisht të gjitha vërejtjeve që ai bëri për projektligjin, më bëri

përshtypje një vërejtje e tij, e cila lidhej me të drejtën e një akademiku në moshën 75-vjeçare për të qenë anëtar i Akademisë, por pa të drejtë zgjedhjeje në bordin drejtues.

Ku e keni marrë këtë model, që i hiqet e drejta, përderisa ai është anëtar dhe ka të drejtë të votojë, por nuk paska të drejtë të zgjidhet?

Vasil Tole – Zoti Ylli, faleminderit për pyetjen!

Ky është një model që vjen nga mbarë Europa dhe është një sugjerim që na e bënë kolegët e Akademisë Kombëtare Gjermane “Leopoldina”, ata austriakë dhe përgjithësisht bordi i ALLEA-s, të cilët investuan një departament juridik për përgatitjen e këtij draftligji.

Është menduar një moshë relativisht e madhe. Ju e keni parasysht që një profesor del në pension në moshën 68-vjeçare, ndërkohë që për akademikët mund të vazhdojë angazhimi pranë Akademisë së Shkencave si anëtar i asamblesë deri në moshën 75-vjeçare, duke pasur të drejtë edhe të zgjidhet në këtë fashë shifrash, pra nga 68-75 vjeç. Mbas moshës 75-vjeçare, akademiku kalon në një status *emeritus*, pra gëzon të gjitha të drejtat, me përjashtim të së drejtës për t’u zgjedhur. Kjo është një gjë shumë normale, sepse ka të bëjë edhe me kombinimet e moshave dhe me energjinë përkatëse, që duhet të reflektojë një personalitet i caktuar, duke kryer një detyrë të rëndësishme, siç është në këtë rast edhe një nga detyrat drejtuese të Akademisë së Shkencave. Kjo është logjika.

Për akademikët mbi 75 vjeç ka qenë shqetësuese situata që kanë qenë pa të drejtë vote deri para dy muajsh, pasi ligji i 2006-s i privonte këta akademikë nga e drejta e votës, gjë që tashmë, ju e dini, u korrigjua me një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe me një vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në rastin e akademikut Apollon Baçe.

Fatjona Dhimitri – Zoti Tole dhe zonja Ministre, cili është definicioni i akademisë sipas këtij projektligji: asamble? Sepse në projektligj citohet thjesht asamble.

Po, urdhëroni zoti Tole!

Vasil Tole – Dëshiroj të bëj një paralelizëm me Kuvendin.

Praktikisht, Kuvendi i Shqipërisë janë deputetët. E njëjta gjë është edhe për Akademinë e Shkencave. Akademia e Shkencave janë anëtarët e saj. Trupa e përbashkët janë anëtarët e akademisë, pra është asambleja. Ne e gjykojmë korrekte të jetë kështu, siç është shkruar në ligj. Akademia e Shkencave është asambleja, pra janë sinonime të njëra-tjetrës. Kjo është korrekte, edhe në pikëpamjen e kuptimit, edhe në pikëpamjen ligjore.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Kostaq Papa – Në fakt, ndërhyrja ime ka të bëjë me faktin që kemi ardhur këtu dhe jemi gjithë sy e veshë për të dëgjuar ministren deri në momentin e fundit. Ajo tha se foli vetëm

për fillimet, apo jo? Kështu që ne duhet të vazhdojmë të dëgjojmë ndoshta edhe përfaqësuesin tjetër për gjëra specifike dhe të vazhdojmë me pjesët e tjera deri në fund të projektligjit.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri –Do të ishte mirë të ishte i pranishëm edhe grupi iniciator, të cilit mund t'i drejtonim edhe pyetje për draftimin e këtij projektligji, pra grupi i ekspertëve.

Sekretariati i komisionit, a ishte ftuar grupi iniciator për të qenë pjesë e komisionit? Nuk është i pranishëm këtu.

Milva Ekonomi – Kemi vetëm zotin Tole, që është anëtar i grupit të punës.

Është grupi i deputetëve që ka të drejtë të ftojë anëtarët e grupit të punës dhe, në këtë këndvështrim, lejuar nga Rregullorja, zoti Tola është pjesë e grupit të punës dhe prandaj është sot i ulur këtu.

Fatjona Dhimitri – A dëshiron dikush të bëjë pyetje?

Milva Ekonomi – Do të kërkoj vetëm diçka nga zonja ministre.

Ne kemi bërë shumë dëgjesa dhe kemi kërkuar nga të gjithë ata që kanë ardhur dhe kanë shprehur mendime për projektligjin të na depozitojnë me shkrim mendimet e tyre, sepse që nga momenti që mbarojnë dëgjesat, puna në komision fillon për të diskutuar nen për nen të gjitha ndryshimet që janë propozuar, si ato që vijnë nga platforma “Fuga”, nga rektorati apo nga ekspertë të pavarur, që kanë depozituar komente në sekretarinë e komisionit.

Prandaj, do t'ju luteshim edhe juve, që opinionet për nene të caktuara t'i depozitoni pranë sekretariatit të komisionit dhe komisioni të fillojë punën për çdo nen të këtij projektligji.

Besa Shahini – Zonja Ekonomi, të gjitha komentet tona, vërejtjet dhe sugjerimet, janë reflektuar te komentet që kemi marrë nga Këshilli i Ministrave, ku janë të përfshira edhe komentet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe ato të Ministrisë së Drejtësisë, pra si tri ministri që kanë pasur sugjerime. Nëse kemi diçka tjetër shtesë, që mund t'ju vijë në ndihmë gjatë këtij procesi, mund ta depozitojmë që nesër, por nuk thamë ndonjë gjë të re nga ato që janë të përfshira te komentet që keni marrë nga ne përmes Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A ka diskutime të tjera?

Mendoj se duhet të kishte më tepër diskutime, nëse do të ishin të pranishëm edhe persona të tjerë përgjegjës, siç e thashë, zoti Shtino apo edhe grupi iniciator.

Milva Ekonomi – Nuk ka më diskutime të tjera, por mendoj se duhet të hedhim në votim miratimin në parim të projektligjit.

Pra, jeni dakort me miratimin në parim të projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë?” Dakort! Miratohet në parim projektligji.

Fatjona Dhimitri - Atëherë, seanca e sotme dëgjimore konsiderohet e mbyllur.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA